



Vechro Pro Relief

Bojë akriliku me efekte teksturë



Aftësia mbuluese: 1 - 1,5 m² /kg



Tharja: ½ - 1 orë



Hollimi: Gati për përdorim



Mundësia për shtresë të dytë:
4 - 6 orë



Paketimi: 5kg , 15kg



Aplikimi: Furçë e trashë, spatul, rul me sfungjer për tekstura të veçanta

KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Bojë emulsioni 100% akrilik për tekstura të cilësisë së lartë. Falë kësaj përbërje të veçantë, sipërfaqet e dekoruara kanë një teksturë të përkryer. Mund të përdoret për të lyer mure të reja ose të vjetra të lyera. E përshtatshme për mbrojtjen dhe dekorimin e sipërfaqeve të brendshme dhe të jashtme, të tilla si mure, suva dhe sipërfaqe betoni, nëse janë lyer siç duhet me astar.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

Tekstura	E sheshtë
Pesha specifike	1,65 - 1,70 kg/lt.
Aftësia mbuluese	1,0 - 1,5 m ² /kg për shtresë, në varësi të sipërfaqes.
Hollimi	Gati për përdorim.
Tharja	Thahet për ½ - 1 orë. Boja ngurtësohet pas 3-4 javësh.
Mundësia për shtresë të dytë	4 - 6 orë. Koha mund të zgjatet në mot të ftohtë dhe me lagështi.
Kategoria e POA	a. "Veshje e mureve të jashtme me nënshtresë minerale". Tipi WB. Limiti i POA =40 gr/lt. b. "Veshje të brendshme mat për mure dhe tavane". Tipi WB. Limiti i POA = 30 gr/lt. POA maksimale e produktit gati për përdorim = 20 gr/lt. Përbush kërkesat e legjislacionit të KE pas vitit 2011. POA: përbërës të avullueshëm organikë me pikë vlimi < 250 °C.
Nuancat	E bardhë.



PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Pastroni sipërfaqen nga pluhurat, vajrat, shtresat e bojërave dhe lagështia. Fërkojeni mirë me letër smerili dhe lyeni sipërfaqet e lyera me gëlqere të bardhë ose sipërfaqet e reja prej betoni me astar Smaltoplast Universal ose Vechro Pro Smaltodur, ndërsa sipërfaqet shumë të pista (lagështirë, nikotinë, bojë, kërpudha, grafiti, njolla vaji, etj.) duhet të lyhen me astarin e veçantë Smaltox Hydro ose Smaltox Mono.

APLIKIMI

Përzieni mirë përpara përdorimit. Aplikoni një ose dy shtresa bojë Vechro Pro me anë të një furçe të trashë, spatule ose ruli pa hollues. Përpara se të thahet, i kalojmë edhe një shtresë tjetër me një rul të veçantë me sfungjer për ta dekoruar.

PAJISJET E PASTRIMIT

Ndërsa punoni, mbajini pajisjet të lagura, qoftë në një kovë apo në mbajtësen e bojës. Shkundini mirë në kovë mjetet nga boja dhe pastrojini menjëherë ujë dhe sapun.

KUSHTET E APLIKIMIT

Temperatura 8-30 °C dhe niveli relativ i lagështirës më i ulët se 80 %. Kushtet e këqija të motit mund ta përkeqësojnë cilësinë e bojës. Sipërfaqet e reja të çimentos duhet të thahen dhe të trajtohen 3-4 javë përpara lyerjes.

RUAJTJA

Ruajini në një vend të freskët, mbroni nga ngrirja dhe ekspozimi në diell. Mbylleni mirë kutinë pas aplikimit në mënyrë që të ruhet në kushte të mira. Mblidheni bojën e papërdorur për ta përdorur më vonë. Ripërdorimi i bojës mund të minimizojë në mënyrë efektive ndikimin e ciklit të jetës së produktit në mjedis.

ETIKETIMI

Astari Smaltolux Hydro Master nuk ka nevojë për simbole rreziku sipas legjislacionit të KE-së.

SIGURIA

Lexoni etiketën në pjesën e pasme të produktit. Mbajeni larg fëmijëve.



Të dhënat dhe udhëzimet teknike të përfshira në këtë fletëpalosje teknike bazohen në kontrollet e laboratorëve konfidencial dhe janë rezultat i njohurive dhe përvojës së stafit shkencor të shoqërisë. Cilësia e produktit garantohehet nga shoqëria, i cili është në përputhje me kërkesat e ISO 9001, 14001 dhe EMAS. Si prodhues, ne nuk mbajmë përgjegjësi për asnjë dëm apo dëme të shkaktuara nëse produkti nuk është aplikuar për përdorimin e duhur dhe në përputhje me udhëzimet për përdorimin.